

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	16-vjeçari lufton me leuceminë akute, Enisi ka nevojë urgjente për ndihmën e shqiptarëve
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1394083.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 12:20:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	25 shtator 2026, 12:11:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 25 shtator 2026, 12:10:00 UTC → 25 shtator 2026, 12:12:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	bdd18ef9fe306e21a47caf4ad80d1507919eef75d7444ba48911dce3507dce65
TEKSTI	d6b48f2a98eb4ea9b45eb5b89bceb39e773827f2ce4db03402427c854b27f50c
PAMJA	c90480d1957c68aae870c820c27f7aff3b38d59e7938d4739beb421e1e1438bd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f62632f2804f0b0b9a0d3923e3053ff48348e07c225713596b72ffd843bb39bc
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3f529bf32420afe1b21bc6d3b8138bcb5df45885bcaf02ba5967dcac0a879fe4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f62632f2804f0b0b9a0d3923e3053ff48348e07c225713596b72ffd843bb39bc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

16-vjeçari lufton me leuceminë akute, Enisi ka nevojë urgjente për ndihmën e shqiptarëve

Shkruar nga: U Tafa | Publikuar më: 25.09.2026, 14:11



Share



Share



LINKU I GOFONDME

Enisi mezi po priste të niste një tjetër vit shkollor. Çantën e vjetër, librat dhe rrobat e dhuruara i kishte bërë gati, ndërsa ëndrra e tij ishte të rikthehej në shkollë dhe të vazhdonte vitin e dytë të arsimit profesional për kuzhinë. Por vetëm dy ditë para se të ulej sërish në bankat e shkollës, jeta e 16-vjeçarit mori një kthesë të papritur dhe të dhimbshme.


Një plagë në buzë dhe temperaturë e lartë alarmuan nënën, e cila e mori djalin në spital. Gjatë rrugës, gjendja e tij u përkeqësua aq shumë sa Enisi nuk kishte më fuqi të ecte dhe u mbështet mbi shpatullat e nënës. Pas analizave dhe ekzaminimeve, familja mori lajmin që askush nuk do të donte ta dëgjonte: 16-vjeçari është diagnostikuar me **leucemi akute** dhe ka nevojë urgjente për trajtim jashtë vendit, me transport të specializuar.

Që prej asaj dite, ëndrrat e Enisit janë zëvendësuar me luftën për jetën. Ai nuk mund të lëvizë, mbahet me oksigjen dhe nuk ka fuqi as të ushqehet. Uniforma e kuzhinierit, të cilën e donte aq shumë, ka mbetur mbi krevatin e tij, ndërsa vëllai i vogël e përqafon çdo ditë me mall.

Në shtëpi, edhe gjyshja e sëmurë pret kthimin e tij. Diabeti i ka shkaktuar asaj amputimin e gishtave, por sot shqetësimi më i madh i familjes është gjendja e rëndë e 16-vjeçarit.

Enisi ka vetëm një dëshirë: të shërohet dhe të kthehet në shtëpi, pranë vëllezërve të tij. Të ulet sërish në bankën e shkollës, të veshë uniformën e kuzhinierit, të shkojë në xhami dhe, pas mësimit, të rikthehet në punën në market, ku punonte për të ndihmuar familjen.

Babai punon në ndërtim, ndërsa nëna kujdeset për fëmijët. Familja jeton me gëra dhe të ardhurat e tyre nuk janë të miftueshme për të nërballuar trajtimin



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

qra dhe te arrihet e tyre nje jare te ngjashme per te perbehere tregimin urgjent qe i nevojitet djalit.

Sot, dy prindërit e Enisit, me lot në sy, i drejtohen shqiptarëve kudo që ndodhen për t'u kërkuar ndihmë. Për ta, nuk bëhet fjalë për të rikthyer thjesht një vit shkollor të humbur. Bëhet fjalë për t'i dhënë djalit të tyre mundësinë të jetojë, të shërohet dhe të rikthehet një ditë në jetën që e ndërpreu kaq papritur.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.